



VENDIM

NR. 25, DATË 18/04/2016

PËR

**PÛRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE QË DO TË
PLOTËSOJNË FORMULARËT E VETËDEKLARIMIT, NË BAZË TË LIGJIT NR. 138/2015, "PËR
GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË
FUNKSIONE PUBLIKE**

Në bazë të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ligjin nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit të Arteve, shkresës të DAP-it me nr.1487 prot. datë 14.04.2016,

VENDOSI

- 1). Përcaktimin e funksioneve që zgjidhen, emërohen në Universitetin e Arteve që do të plotësojnë formularët e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:
 - a) Rektori dhe kandidatët për Rektor, të Universitetit të Arteve;
 - b) Administrator/Kancelar i Universitetit të Arteve;
 - c) Dekan dhe ish Dekan ;
 - d) Zv/rektor dhe ish Zv/rektori Universitetit të Arteve;
 - e) Zv/dekan dhe ish-zv/dekan;
 - f) Përgjegjës Departamenti dhe ish- përgjegjës Departamenti;
 - g) Administrator/Kryetar dege në Fakultet;
 - h) Drejtor në rektoratin e Universitetit të Arteve;
 - i) Përgjegjës sektori;
 - j) K/sekretaret e fakulteteve në UART.
2. Vendimi të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve;
3. Sektori i IT, pranë rektoratit të UART të asistojë personelin në plotësimin e formularëve vetëdeklaruese;
4. DMBNJ, **brenda datës 20 prill 2016**, të vërë në dispozicion të Departamentit të Administratës Publike, **në formë elektronike**, të shpallur në faqen zyrtare (*internet*), listën e punonjësve sipas funksioneve aktuale, që do të plotësojnë formularët e vetëdeklarimit;
5. Funksionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të dorëzojnë, shkresërisht pranë Departamentit të Administratës Publike formularët e vetëdeklarimit **deri në datën 5 maj 2016**, kurse Rektori dhe kandidatët për Rektor pranë Presidencës.